

V E N D I M
Nr.332, datë 15.7.1999

PËR RIORGANIZIMIN E KOMISIONIT SHTETËROR TË ADIOKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7.1, të ligjit nr. 8038, datë 23.11.1995 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Riorganizimin e komisionit shtetëror të radiokomunikacioneve, me këtë përbërje:

- | | |
|--|-----------------|
| - Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit | kryetar |
| - Ministri i Informacionit | zëvendëskryetar |
| - Drejtori i komunikimeve në Ministrinë e Mbrojtjes | anëtar |
| - Drejtori i ndërlidhjes në Ministrinë e Rendit Publik | “ |
| - Drejtori i ndërlidhjes në SHIK | “ |
| - Drejtori i radiokomunikacioneve në ERT | “ |
| - Anëtar i Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit | “ |
| - Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të PT-së | sekretar |

2. Anëtarët e komisionit ndihmohen nga:

Këshilltar ekspert në fushën e radiokomunikacioneve

Këshilltar ekspert në fushën juridike.

Këshilltarët caktohen nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

3. Komisioni Shtetëror i Radiokomunikacioneve është organ kolegjal dhe konsultativ i Këshillit të Ministrave dhe funksionon në bazë të një rregulloreje të hartuar nga komisioni dhe të miratuar nga kryetari i tij.

Ai mbledhet jo më pak se një herë në 3 muaj, me propozimin e kryetarit ose me kërkesën me shkrim të të paktën e 1/3 së anëtarëve të komisionit.

Mbledhjet e komisionit zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën 2/3 e anëtarëve.

4. Për të kryer veprimtarinë komisioni shtetëror i radiokomunikacioneve ka këto detyra dhe të drejta:

a) Harton dhe i propozon Këshillit të Ministrave:

- planin kombëtar të ndarjes së brezave të frekuencave për të gjitha shërbimet e radiokomunikacioneve në vendin tonë (për nevoja civile dhe ushtarake), duke u mbështetur në planin përkatës të “Rregullores ndërkombëtare të radiokomunikacioneve”. Plani i hartuar t’i japë përparësi plotësimit të nevojave të mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë së vendit;

- zgjidhjen e problemeve, që lindin ndërmjet shërbimeve të radiokomunikacioneve, gjatë zhvillimit të tyre.

b) Shqyrton dhe jep mendim për propozimet që kanë të bëjnë me radiokomunikacionet dhe që i paraqiten Këshillit të Ministrave.

c) Harton objektivat afatgjata të administrimit të frekuencave për shërbimet e ndryshme të radiokomunikacioneve, duke mbajtur parasysh kërkesat e ditës dhe të së ardhmes, si dhe bën rishikimin periodik të tyre.

ç) Propozon rregullat dhe kushtet e bashkëveprimit ndërmjet ERT-së dhe operatorëve të telekomunikacioneve me organet e mbrojtjes e të sigurisë së vendit në fushën e administrimit të radiofrekuencave.

5. Anëtarët e komisionit të shpërblehen me 40 000 (dyzetë mijë) lekë në vit, kurse këshilltarët e këtij komisioni të shpërblehen me 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në vit. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të parashikojë në shpenzimet buxhetore fondet e nevojshme për këtë shpërblim.

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.908, datë 2.12.1996, “Për riorganizimin e komisionit shtetëror të radiokomunikacioneve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko